Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Njesi/Sasi	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	Afati
1	Upgrade i mjedisit ku është instaluar dhe teknologjive ku bazohet Mobiread	Sherbim / 1			6 muaj
2	Upgrade dhe permiresim i sistemit Mobiread	Sherbim / 1			6 muaj
3	Dorezimi i manualeve teknik, rekomandimeve te sigurise, licensave te perditesuara te software aty ku nevojitet.	Sherbim / 1			6 muaj
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Upgrade i teknologjise Hardware/Software si dhe përditësim të funksionaliteteve në sistemin e matjes Mobiread”:

Përmbajtje

HYRJE	5
1.1 Qëllimi.....	5
REZULTATET QË DUHET TË ARRIHEN.....	5
KËRKESA FUNKSIONALE.....	6
3.1 Sistemi Mobiread.....	6
3.2 Përshpejtimi i proceseve të punës.....	6
3.3 Përdorimi i teknologjive “container”	7
3.4 Përdorimi i teknologjive “container orchestration”	8
3.5 Realizimi i cluster HA për databazën.....	8
3.6 Konfigurimi i cluster të shërbimeve.....	8
3.7 Upgrade për të përmirësuar procesim asinkron.....	8
3.8 Upgrade duke përdorur “Single Page Progressive Web App” për Mobiread.....	9
3.9 Shtimi i fushave për leximin e energjisë së importit për vetëprodhuesit.....	9
3.10 Upgrade i konvencioni të emërimit të fotove.....	9
3.11 Shfaqjen e leximeve sipas tipeve të leximeve.....	9
3.12 Fushë për shënime në lexim.....	10
3.13 Qendra e raporteve	10
3.14 Api Log	10
3.15 Feeder/Kabine	10
3.16 Kabina lexuar mbi 90%.....	10
SIGURIA E SISTEMIT.....	11
4.1 Përditësimet e komponenteve	11
4.2 Implementim i sigurt	11
4.3 Testimi i sigurisë.....	11
4.4 Sesionet active	11

4.5 <i>Ndryshimi I portave</i>	11
4.6 <i>Administratorët</i>	11
KËRKESAT TEKNIKE	12
LOGJISTIKA DHE KOHA	13
6.1 <i>Vendndodhja</i>	13
6.2 <i>Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave</i>	13
RAPORTIMI	13
7.1 <i>Kërkesat për Raportimin</i>	13
PLANIFIKIMI I REALIZIMIT TË PËRMIRËSIMEVE NË SISTEM	14
NIVELET E SHËRBIMIT SLA	14
9.1 <i>Koha e ofrimit të shërbimit (SLA)</i>	15

HYRJE

Sistemi MOBIREAD përdoret nga OSHEE Sh. a për administrimin e procesit të leximit të matësve të energjisë elektrike në të gjithë Shqipërinë. Programi përdoret nga specialistët që monitorojnë procesin nëpërmjet ndërfaqes backend dhe lexuesëve që kryejnë procesin e mbledhjes së të dhënave të matësve me anë të App Mobile duke përdorur aparatet mobile PDA.

Në total në sistem janë të regjistruar mbi 4722 përdorues nga të cilët aktiv në një muaj janë jo më pak se 1730. Nga këta, cdo muaj janë aktiv të paktën 900 lexues të cilët përdorin App mobile në PDA që komunikojnë me sistemin qendror dhe të paktën 830 përdorues në sistemin qendror në role të ndryshëm.

OSHEE Group Sh.a është përcaktuar si operator i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit. Në këtë kontekst OSHEE Group Sh.a duhet të auditojë sistemet në përdorim në mënyrë periodike, të marrë masa për përditesimin e tyre, të ketë një plan të menaxhimit të riskut dhe të raportojë po në mënyrë periodike në AKCESK.

1.1. Qëllimi

Qëllimi I përgjithshëm është të bëhet upgrade sistemi MOBIREAD dhe teknologjitë përbërëse, ndërtimi I ndërfaqeve në teknologjinë HTML, rritja e sigurisë, të përmirësohen proceset aktuale të punës të sistemit MONIREAD në aspekte të ndryshme për të rritur eficienten dhe efektivitetin e të gjithë përdoruesve të këtij sistemi qofshin ata lexues të cilët përdorin PDA-të apo përdorues të cilët menaxhojnë proceset e ndryshme dhe kryejnë verifikime të nevojshme nga ndërfaqja e administrimit.

REZULTATET QË DUHET TË ARRIHEN

Rezultatet konkrete që duhet të arrihen nga operatori ekonomik janë:

Ndërtimi i ndërfaqeve të përdoruesve në teknologji HTML;

Upgrade i server të raporteve;

Upgrade i server të aplikimit;

Upgrade i server të databazës;

Upgrade i sistemit të operimit për server të aplikimit dhe server te databases;

Përshpejtimi i proceseve të punës të sinkronizimit me skemën ndërmjetëse CRM-MR;

Ndryshime dhe përmirësime në aplikacionin mobile dhe ndërfaqet web;

Rritja e sigurisë së sistemit nëpërmjet testimit e auditimit të sigurisë të sistemit të dorëzuar, krijimit dhe përditësimit të planit për menaxhimin e riskut;

Rritja e transparencës së proceseve në sistem, duke realizuar ndërfaqe më miqësore për gjurmimin dhe auditimin e veprimeve;

Trajnim për stafin për sistemin e përmirësuar si dhe gjithë përbërësit e tij (database, aplikacion);

Dorëzimi i manualeve teknik, rekomandimeve të sigurisë, licensave të përditësuara të software aty ku nevojitet;

KËRKESA FUNKSIONALE

3.1. Sistemi Mobiread

Sistemi aktual Mobiread duhet të jetë në gjendje pune të vazhdueshme. Zhvillimet dhe përmirësimet e kërkuara në infrastrukturë duhet të kryhen duke garantuar vijueshmërinë e punës së sistemit ekzistues Mobiread.

3.2 Përshpejtimi i proceseve të punës.

Arkitektura aktuale e sistemit Mobiread përkufizohet si arkitekturë monolite. Tashmë është evidentuar, se do të përbënte përmirësim përshatja e arkitekturës duke ndarë akoma më tej në module të pavarura disa funksionalitete të sistemit, për të evituar që mbingarkesa e një procesi të ndikojë në procese të tjera pune. Ndarja e mëtejshme në module, pa çënuar aspektin funksional të sistemit lehtëson shkallëzimin e sistemit për të përballuar një ngarkesë më të lartë. Përdorimi i teknologjive si Docker dhe Kubernetes apo ekuivalente me to do të lehtësonte shkallëzimin e sistemit për të menaxhuar ngarkesën gjatë procesit të leximit të matësave në terren.



Fig 1 – Skema - “Container, Container orchestration”

Kërkohet që të bëhen upgrade të gjithë funksionet e sistemit ku kryhet procesim në paralele ose asinkron në mënyrë që të rritet shpejtësia e kryerjes së proceseve.

Aktualisht sistemi komunikon me një nyje të vetme të databazës. Shkrimet nga sistemi rritin kohën e marjes së informacionit nga reportet, pasi krijohen situata të bllokimit të ndërsjelltë. Në periudha të ngarkesës së lartë ka edhe raste të dështimit të transaksioneve. Në të tilla raste procesi në progres dështon duke bërë që përdoruesit të ritentojnë veprimin e fundit dhe rrjedhimisht të shkaktojnë një ngarkesë artificiale më të madhe në sistem. Zgjidhjet e dhëna në raste të tilla janë manuale dhe konsistojnë në kontrole të integritetit të të dhënave dhe përditësime automatike në varësi të fushave të përditësuar. Duke qënë se kapacitetet hardware janë shtuar dhe gjithashtu përmirësuar në performancë dhe kapacitet përpunuese, mendohet që infrastruktura mbështetëse e sistemit Mobiread duhet të përmiresohet po ashtu në këtë kontekst në disa drejtime të cilat dalin edhe nga parashtrimi i situates mësipër.

3.3 Përdorimi i teknologjive “container”

Ndarja në nën-module të disa përbërësve funksionale të sistemit Mobiread do të mundësojë vendosjen e tyre në “container”. Kjo ndarje mundëson zhvillimin dhe përshtatjen e pjesëve të ndara nga ana funksionale e sistemit, duke lehtësuar gjithashtu dhe menaxhimin e tyre. Çdo nën-modul mund të përgatitet dhe të implementohet pavarësisht nga pjesa tjetër e sistemit, duke lejuar shpejtësi dhe efikasitet në procesin e përditësimit të kërkuar të sistemit apo përmirësimeve të vazhdueshme. Në të njëjtën kohë, përdorimi i “container” siguron izolim të plotë për secilin nën-modul, duke garantuar që ndryshimet në një pjesë të sistemit nuk kanë ndikim në pjesët e tjera.

3.4 Përdorimi i teknologjive “container orchestration”

Orkestrimi i “container” është i rëndësishëm për menaxhimin dhe koordinimin e “container” që do të përbëjnë sistemin e përmirësuar. Sistemet e orkestrimit ofrojnë avantazhe të mëdha duke lejuar automatizimin e publikimit të versioneve të reja të sistemit (“deploy”), shkallëzim dinamik të përdorimit të burimeve, menaxhimin e ngarkesës dhe ri-nisjes së nën-moduleve në rast të situatave të pa-parashikuara të ndërprerjes së funksionimit normal të tyre. Ky nivel i automatizimit dhe orkestrimit do tu lejojë ekipeve operacionale të menaxhojnë këtë sistem me efikasitet dhe të përgjigjen më shpejt në situata të ngarkesës. Orkestruesi mund të menaxhojë automatikisht krijimin e njësisive/instanceve të reja të “container” në varësi të ngarkës së punës dhe kërkesave të sistemit përkundrejt një nën-moduli specifik. Në këtë mënyrë, orkestrimi i “container” do të mundësojë rritjen e kapaciteteve (shkallëzim horizontal) automatike gjatë periudhave të ngarkesës duke mundësuar jo vetëm që përdorimi i burimeve të bëhet më eficient por gjithashtu që mundësite e shkallëzimit të jenë pa limite duke mundësuar flukse të veprimeve të pakufizuara.

3.5 Realizimi i cluster HA për databazën

Të gjitha nyjet e cluster duhet të suportojnë shkrim dhe lexim, në mënyrë të tillë që nëse njëra prej nyjeve del jashtë shëbimit të vijojë veprimtaria normale me sistemin. Nyjet duhet të replikojnë në konfigurim Master-Master dhe Active-Active. Nëse shkruhet në njërin prej nyjeve përbërëse të cluster duhet të realizohet përditësimi i të gjitha nyjeve të tjera.

3.6 Konfigurimi i cluster të shërbimeve

Teknologji si Kubernetes mundësojnë shpërndarjen e ngarkesës midis containers. Konfigurimi i “cluster” në modalitetin e shpërndarjes së ngarkesë do të mundësonte një menaxhim më të mirë të kërkesave drejta sistemit Mobiread, duke ulur numrin e dështimeve për shkak të ezaurimit të burimeve të server.

3.7 Upgrade për të përmirësuar procesim asinkron

Sistemi Mobiread është një sistem i cili ka një numër të lartë të veprimeve asinkrone. Veprime si shkrimi në database, leximi nga databaza, komunikimi me anë të web-shërbimeve me sisteme të tjerë, janë veprime tërësisht asinkrone, shkurtimisht përgjigja për këto veprime vjen në një kohe të mëvonshme. Gjatë kohës së pritjes, shërbimi kryesor i Mobiread, do të qëndrojë i zënë me pamundësi për të servitur kërkesa të reja, për përdorues të tjerë. Sistemi duhet të bëhet upgrade që të mundësojë aplikime “real-time”, pra me komunikim në kohe reale – cka do të rriste shpejtësinë e reagimit të ARMS Mobile App në rast të ndryshimeve të kryera nga përdoruesit administratore, si psh: ndryshim plan leximi, kërkesë për ri-lexim, kërkesë për foto të detyruar etj. Një aspekt tepër i rëndësishëm është zbatimi i praktikave të programimit të sistemeve të sigurta, duke vendosur mekanizma të autentikimit, autorizimit, verifikimit të kërkesave, sigurimit të parametrave etj... për tu mbrojtur nga tentativa keqdashëse të aksesimit të sistemit.

3.8 Upgrade duke përdorur “Single Page Progressive Web App” për Mobiread

Single Page Progressive Web App janë arkitektura moderne për organizimin e sistemeve të cilat përdoren nga ndërmarrjet. Në këtë arkitekturë mundësohet përdorimi i teknikave standarte të ngarkimit të ndërfaqeve në mënyrë të optimizuar. Ndërfaqet ngarkohen vetëm një herë në rast të ndryshimeve dhe në vijim ato qëndrojnë në memorje të shfletuesit të quajtur “cache”. Në rast të ndryshimeve duhet të eliminohet nevoja që përdoruesit të duhet të realizojnë veprime si “clear cache” për të vënë në funksion ndryshimet e realizuara. Aplikimi duhet të mund të ri-freskojë të gjithë përbërësit e ndryshuar. Gjaë ngarkimeve të mëtejshme të ndërfaqeve, aplikimi klient ri-freskon vetëm të dhënat në një komunikim me madhësi më të reduktuar me server duke përshpejtuar ngarkimin e të dhënave. Aplikimi duhet të ofrojë “deep linking” ose thënë më thjeshtë mundësinë e ngarkimit të regjistrimeve apo ndërfaqeve të ndryshme nëpërmjet lidhjeve unike të cilat duhet të përmbajnë dhe informacion identifikues të regjistrimit të aksesuar nga një përdorues i caktuar. Lidhjet e tipit “deep linking” duhet të mundësojnë ndarjen e lidhjeve midis përdoruesve dhe aksesimin e tyre nga përdoruesit e tjerë gjithmonë duke respektuar të drejtat e aksesit të një burimi të dhënë. Aplikimi duhet të implementojë avantazhe të cilat ofrohen nga Progressive Web App për të optimizuar përdorimin e aplikimit në disa dritare (ose “tabs”) njëkohësisht. Me anë të teknikave Progressive Web App duhet të optimizohet edhe përdorimi i memorjes “cache” nga aplikimi i ofruar.

3.9 Shtimi i fushave për leximin e energjisë së importit për vetëprodhuesit

Kërkohet të shtohen fusha të reja për leximin e këtyre vlerave të energjisë. Për të realizuar këtë kërkesë është e nevojshme të shtohen këto fusha në ndërfaqen e ARMS Mobile App, realizimi i ndryshimeve në shtresën e logjikës, dhe të aksesimit të dhënave etj.

3.10 Upgrade i konvencioni të emërtimit të fotove

Emri I fotove të përmbajë tipin e leximit (energji active, pik,reactive import,eksport), vlerën e leximit e cila duhet të jetë sa vlera e leximit në momentin e kryerjes së fotos.

3.11 Shfaqjen e leximeve sipas tipeve të leximeve

Shfaqjen në mënyrë të dukshme në PDA leximet sipas llojit të mënyrës së leximit (mobiread , pik, converge) e cila vlen edhe për rastet kur matësat kanë vetem lexime active dhe reactive.

3.12 Fushë për shënime në lexim

Kërkohe të shtohet një fushë për shënime mbi një lexim me tekst të lirë e cila plotësohet nga lexuesit në rastet kur nevojitet. Për të realizuar këtë kërkesë nevojiten ndryshime në shtresën e logjikes, dhe të aksesimit të dhënave etj

3.13 Qendra e raporteve

Në këtë modul perdoruesit gjenerojnë të gjithë raportet në lidhje me leximet e kryera në terren, kabinat si dhe feederat.

Pas gjenerimit të raporteve në excel nuk mund të bëhen veprime të ndryshme në këto raporte pasi ka shumë qeliza që janë merge ose blank.

Kërkohe të bëhet sistemimi i këtyre raporteve, në formatin tip excel / csv pa kollona apo rreshta blank ne mes te raportit pas gjenerimit, që perdoruesit të mund të kryejnë veprimet e metejshme të nevojshme per perpinim te informacionit.

3.14 Api Log

Shfaqen të gjitha loget që kanë të bëjnë me lexuesin, por në rastet kur dështon logimi, problemi i version të ARMS App Mobile, nuk shfaqet emri I perdoruesit. Duhet të bëhet e mundur shfaqja e emrit të lexuesit kur ndodhin errore të tilla.

3.15 Feeder/Kabine

Në moduln feeder/kabinë është e nevojshme që përvec numrit total të abonentëve, të shtohet edhe numri I abonentëve të lexuar për secilen kabinë sido që të jetë statusi I kabinës gjatë procesit të leximeve.

3.16 Kabina lexuar mbi 90%

Në këtë modul shfaqen kabinat që gjatë procesit të leximit janë kryer 90% deri ne 100% të leximeve të abonentëve. Në disa raste, edhe pse janë lexuar 100% të abonentëve, kabinat nuk mund të mbyllen nga lexuesit. Duhet të bëhet e mundur aktivizimi I butonit mbyll kabina 100%. Me atë të këtij butoni administratorët e sistemit Mobiread mund të bëjnë të mundur mbylljen e këtyre kabinave.

SIGURIA E SISTEMIT

4.1 Përditesimet e komponenteve

Të gjithë pjesët përbërëse të sistemit dhe ambientit ekzistues ku do të instalohet sistemi, apo instalime e konfigurime të reja duhet të bëhen upgrade në versionet më të fundit.

4.2 Implementim i sigurt

Implementim i upgrade-ve të kërkuar, ku përfshihet instalimi dhe konfigurimi i tyre, duhet të bëhet duke zbatuar të gjithë parimet e sigurisë për të shmangur risqe të panevojshme të cilat mund të shmangen duke bërë konfigurimet e duhura. Një nga aspektet kryesore është të mos tregohet neglizhenç duke i lënë komponentet dhe sistemin të konfiguruar me parametra “default” por të ndiqen parimet më të mira të sigurisë.

4.3 Testimi i sigurisë

Zhvillim i testimit dhe auditimit të sigurisë për të gjithë pjesët përbërëse të infrastrukturës në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen vulnerabilitetet e mundshme dhe për të ruajtuar sigurinë.

Me dorëzimin e sistemit duhet të dorëzohet dhe raporti i auditimit të sistemit dhe infrastrukturës dhe akseset specifike.

4.4 Sesionet active

Përdoruesit e sistemit duhet të kenë vetëm një session activ. Pra një username mos të përdoret në më shumë se një paisje në të njëjtën kohë.

4.5 Ndryshimi I portave

Për arsye sigurie portat e komunikimit që përdorin specialistët që monitorojnë procesin duhet të jenë të ndryshme nga portat që përdorin lexuesit në terren me PDA.

4.6 Administratorët

Përdoruesit e sistemit me rol admin, për arsye sigurie duhet të logohen vetëm nga një IP private e paracaktuar.

KËRKESAT TEKNIKE

Infrastruktura aktuale përbëhet nga makina virtuale për sistemin “production”, “development” dhe “test”.

Infrastruktura “production” përbëhet nga server virtual me specifikimet si më poshtë.

Web Server:

Procesor: 8 Core, 2 GHz Hard disk: 150 GB RAM: 16 GB

Infrastruktura Software:

OS: Ubuntu Server 16.04

Web Server: Apache MOD PHP

DB & Reporting Server:

Procesor: 8 Core, 2 GHz Hard disk: 150 GB RAM: 16 GB

Infrastruktura Software:

OS: Ubuntu Server 16.04

Web Server: Apache Tomcat 8.5

DB Server: MySql Server

Teknologjite e sistemit jane: Bazuar në web,

App mobile sistem operimi Android,

Zjidhja: ARMS,

Gjuha e programimit: PHP, Java Server Pages, Java for Android, Skripte Backup/Restore ne Bash.

Database: Mysql.

Web server: Apache,

Reporting server: Jasper reports.

Dokumentat e ngarkuar në sistem nga përdoruesit dhe arshivimi i databazës ruhen në pajisje network storage e cila është montuar në modalitetin CIFS në sistemet e operimit Ubuntu Linux në web Server dhe DB & Reporting Server.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: OSHEE Group Sh. a

LOGJISTIKA DHE KOHA

6.1. Vendndodhja

Baza operative e projektit do të jetë në Tiranë. Sistemi do të operojë në serverat ekzistues të OSHEE Group sh.a të cilët janë të instaluar në datacenter të OSHEE.

6.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit të projektit do të jetë data e nënshkrimit të kontratës dhe dorëzimi ndahet në 2 faza. Dorëzimi i parë të kryhet brenda 1 muaji nga nënshkrimi i kontratës dhe është upgrade i komponenteve ekzistues të mjedisit ku është i instaluar aktualisht Mobiread, në mënyrë që Mobiread ekzistues të vijojë të jetë funksional në mjedisin e bërë upgrade.

Dorëzimi i plotë i detyrave të mbetura të kontratës duhet të kryhet brenda 6 muajve nga nënshkrimi i kontratës.

RAPORTIMI

7.1. Kërkesat për Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në gjuhën shqipe në original dhe 1 kopje:

o Raporti Fillestar prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet pas dy javësh nga fillimi implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresinë e mbledhjes së të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar.

o Drafti i raportit përfundimtar me numër faqesh maksimale 20. Në këtë dokument do të duhet të përfshihet informacion i detajuar në implementimin e zgjidhjes, modulet e ndërтуara, licencat e përdorura, rolet e përdoruesve, informacion mbi sigurinë e sistemit, llojin e databazës së përdorur informacionet shtesë të nevojshme, informacionin mbi auditin etj. Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një javë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.

o Raporti final me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar përfshin inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 10 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse. Me dorëzimin e sistemit duhet të dorëzohet dhe raporti i testimi dhe auditimit të sistemit dhe infrastruktures.

Përmbyllja e secilës nga fazat e projektit dokumentohet me procesverbal të përpiluar nga ofruesi i shërbimit dhe të firmosur nga punonjësit përgjegjës të të dy palëve.

PLANIFIKIMI I REALIZIMIT TË PËRMIRËSIMEVE NË SISTEM

Më poshtë paraqitet Diagrama për realizimin e përmirësimeve të kërkuara.

Aktiviteti	M1	M2	M3	M4	M5	M6
Upgrade i mjedisit ku është instaluar dhe teknologjive ku bazohet Mobiread	X					
Implementimi i Upgrade dhe përmirësimeve të sistemit Mobiread	X	X	X	X	X	X
Trajnim për stafin për sistemin e përmirësuar						X

Dorezimi i manualeve teknik, rekomandimeve te sigurise, licensave te perditesuara te software aty ku nevojitet.						X
---	--	--	--	--	--	---

NIVELET E SHËRBIMIT SLA

Parametrat SLA përcaktojnë nivelin dhe qëllimin e shërbimit dhe mënyrën ose formën e realizimit të parametrave të paracaktuara. Parametrat e SLA monitorohen gjatë gjithë kohës së shërbimit dhe realizimi i tyre regjistrohet dhe vlerësohet. OSHEE sh.a merr rregullisht një Raport të Shërbimit, në bazë të të cilit do vlerësojë cilësinë dhe nivelin e shërbimeve të ofruara.

9.1 Koha e ofrimit të shërbimit (SLA)

Tabela në vijim përcakton kohëzgjatjen e propozuar dhe kohën e zgjidhjes për rikthimin në funksionimin e rregullt bazuar në mundësitë/ alternativat e SLA

Kategoria A (Kritik/ i Lartë)	Kategoria B (i Mesëm)	Kategoria C (i Ulët)
Mos funksionimi i aplikacionit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit pengon në mënyrë minimal aktivitetin
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesë të punës së tyre	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre
Zgjidhje alternative e përkohshme		
Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	Ka pjesërisht një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	Ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
o 15 min. për të kthyer përgjigje o Në vend brenda 60 min.	o 60 min. për të kthyer përgjigje o Në vend brenda 4 orëve	o 120 min. për të kthyer përgjigje o Në vend brenda 48 orëve
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 2 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 24 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 5 ditë kalendarike.

Shënim: Operatori ekonomik është i detyruar për të zgjidhur problemet e raportuara në mënyrë të rregullt brenda afateve të mësipërme (koha llogaritet nga momenti i raportimit të problemit, në qoftë se është raportuar jashtë orarit të shërbimit, periudha llogaritet për fillimin e orarit të shërbimit në ditën pasardhëse të punës). Në ato raste, kur incidenti ose problemi i raportuar, është urgjent (ku operimi i sistemit prek OSHEE sh.a në afate të kuizuara kohore) shërbimi për zgjidhje duhet të jepet nga Operatori ekonomik sa më shpejt të jetë e mundur.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Upgrade i teknologjise Hardware/Software si dhe përditësim të funksionaliteteve në sistemin e matjes Mobiread

Afatet e ekzekutimit:

Diagrama për realizimin e përmirësimeve të kërkuara.

Aktiviteti	M1	M2	M3	M4	M5	M6
Upgrade i mjedisit ku është instaluar dhe teknologjive ku bazohet Mobiread	X					
Implementimi i Upgrade dhe përmirësimeve të sistemit Mobiread	X	X	X	X	X	X
Trajnim për stafin për sistemin e përmirësuar						X
Dorezimi i manualeve teknik, rekomandimeve të sigurisë, licensave të përditësuara të software aty ku nevojitet.						X

Kohëzgjatja 6 Muaj nga Nenshkrimi i Kontrates

Shërbimi që kërkohet:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i Shërbimeve	Afati
1	Upgrade i mjedisit ku është instaluar dhe teknologjive ku bazohet Mobiread	6 Muaj
2	Upgrade dhe përmirësim i sistemit Mobiread	6 Muaj
3	Dorezimi i manualeve teknik, rekomandimeve të sigurisë, licensave të përditësuara të software aty ku nevojitet.	6 Muaj

Afatet e lëvritimit:

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Dhe referuar Specifikimeve Teknike.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 18,800,000 (Tetembedhjetë e teteqind milion) leke pa TVSH.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qendrueshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2021, 2022, 2023. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të konfirmuara nga organet perkatëse. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 15,000,000 (Pesembedhjetë milion) leke pa TVSH.

- *Për përvoja të mëparshme të realizuara me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohet vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.*

-
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**”.*

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 9001:2015** ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) dhe **ISO 27001:2013** ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi/distributori ose certifikatën e të drejtave të autorit për produkteve software dhe ofrimin e shërbimeve të përfshira në këtë objekt prokurorimi për territorin e Shqipërisë.

Në rast të paraqitjes së autorizimit të prodhuesit/distributorit, autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit të autorizuar si: telefon, fax, e-mail, website, kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar ose me kontratë bashkepunimi jo më pak se 9 (nëntë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj).

Plotesimi i këtij kriteri duhet të vërtetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG për periudhën e muait të fundit duke ju referuar datës së hapjes së ofertave, diplomave të shkollimit të lartë universitar për secilin prej punonjësve, kontratës së punës ose kontratës së bashkepunimit të vlefshme për të gjithë kohezgjatjen e shërbimit objekti kontrate.

Këta punonjës duhet të kenë rolet dhe certifikimet si vijon:

- a. Të paktën 4 (katër) programues/zhvillues software ku të paktën 2 (dy) të jenë të certifikuar në implementim ose zhvillim të zgjidhjes softwerike së ofruar dhe të paktën 1 (një) të jetë certifikuar për zhvillimin ose administrimin e bazës së të dhënave, të paktën 1 (një) në programim app mobile android ose ekuivalent
- b. Të paktën 1 (një) menaxher projekti të certifikuar në nivel profesionist.
- c. Të paktën 1 (një) person të certifikuar në nivel profesionist në sisteme me arkitekturë të orientuar nga shërbimet.
- d. Të paktën 1 (një) person të certifikuar për “container” si Docker ose ekuivalent
- e. Të paktën 1 (një) person të certifikuar për “container orchestration” si Kubernetes ose ekuivalent.
- f. Të paktën 1 (një) person të certifikuar për administrimin e sistemit të operimit.

Shenim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikate.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, per te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per periudhen e dates se hapjes se tenderit.

